



TE REJA NGA SHKBSH

NEWSLETTER PËR VULLNETARËT



SHTATOR 2023

PROJEKTI SHKOLLOR

Shumë të dashur Vullnetarë,
Është bekim të gjendemi së bashku në rrugëtimin për përjetësinë, duke përcjellë mesazhin e Shumë të Lartit dhe duke shërbyer për nevojtarët ashtu siç do t'i shërbenim Atij!

Projekti Shkollor është një projekt i veçantë, ku ShkbsH në bashkëpunim me donatorët, pajis fëmijët e Programeve Secured Childhood dhe Dream Academy, por jo vetëm, me çanta dhe mjete shkollore. Këtë vit, rreth 370 fëmijë në të gjithë Shqipërinë, pjesë e programeve tona së bashku me motrat e vëllezërit e tyre, u pajisën më së miri për këtë fillim viti të ri shkollor. Përveç shpërndarjes së çantave, zhvilluam takime e trajnime me prindërit dhe fëmijët për rëndësinë e Edukimit dhe impaktin e të mësuarit në jetën e përditshme.



Është e rëndësishme të përmendim që, edhe ata prindër që nuk e kishin një ëndërr për fëmijën e tyre, në fund të takimit u frymëzuan të ëndërrojnë për një të ardhme ndryshe, sigurisht më të mirë. Ia vlen të përmendim që një prej këtyre takimeve u bë në oborrin e Burgut 302 në Tiranë, ku 10 fëmijë u pajisën me çanta dhe mjete shkollore.

Në emër të ShkbsH jemi shumë mirënjohës për ndihmën tuaj, dashurinë dhe përkujdesjen që jepni çdo ditë. Jemi mirënjohës për gatishmërinë tuaj, bashkëpunimin, pozitivitetin dhe devotshmërinë. Ndaj lutemi që Perëndia të derdhë bekimet e Tij qiellore në jetët dhe në shërbesat tuaja!
Perëndia ju bekoftë fort!

Irida Hazizi, Koordinatore





HISTORI NGA JETA

Një informacion i shkurtër për Burgun e Kavajës:

Burgu i Kavajës, ose ndryshe i quajtur Burgu i të Miturve, më shumë ngjan me një qendër riedukimi se sa një burg i mirëfilltë. Aktualisht aty vuajnë dënimin 22 të mitur nga moshë 15 deri në moshën 18 vjeçare. Në vend të izolimit, këta të rinj, e kalojnë kohën në programe të ndryshme mësimore, sociale dhe psikologjike si një formë riedukimi për t'u penduar dhe për të mos përsëritur ato vepra penale për të cilat janë dënuar. Puna jonë, si Shkëmbues, ka të bëjë me prezantimin e Ungjillit si e vetmja rrugë pendimi dhe shpëtimi por edhe pajisjen e këtyre të rinjve me vlera njerëzore duke u treguar dashurinë e pakushtëzuar që vjen vetëm nga lart. Ju lutem, shihni impaktin e Ungjillit teksa një jetë ndryshon:



Lindi është një djalë 17 vjeçar nga Shkodra që vuan dënimin në burgun për minorenët në Kavajë. Jeta e tij pa Zotin nuk ka qënë e lehtë, madje vështirësitë nisin që në vegjëli. Historia e tij e trishtë, është e dhimbshme për çdo prind që e dëgjon. I ndikuar nga shoqëria e keqe dhe mungesa e familjes, Lindi e nis jetën me mendimin se çdo gjë është e lejuar. Por, pas disa gabimeve të njëpasnjëshme, ai e gjen veten në brendësi të mureve të burgut të Kavajës. Kështu nis rruga e tij drejt riedukimit. Përshtatja drejt një jete të privuar nga liria nuk ishte e lehtë. Megjithatë, shumë shpejt, Lindi u bë pjesë e takimeve tona në burg.

Në një takim të veçantë, Lindi ishte i vetmi që ngriti dorën për të pranuar Jezusin si Zot dhe shpëtimtar. Një grup i huaj të rinjsh, të pranishëm në atë takim, lanë një impakt të mirë të ecjes krahas me Jezusin. Një javë më vonë, ai bën lutjen e shpëtimit.

Tashmë, ai është shumë i hapur për të mësuar më shumë për Zotin dhe jeta e tij ka ndryshuar dukshëm. Që nga dita që ai kërkoi një Bibël, shumë të tjerë janë ndikuar. Ai lexon dhe pyet, është i hapur për diskutim dhe së bashku me të vijnë edhe shokët e tij. Është kaq bekim të përjetosh frytet e shërbesës në burg, të shohësh jetë të rinjsh që restaurohen në Zotin! Që prej asaj dite, Lindi është i rregullt në shërbesën tonë javore. Për mua si Kapelan, është privilegj dhe përgjegjësi të ndaj Ungjillin në një vend ku vlerat dhe morali janë një sfidë për shoqërinë, por me Zotin asgjë nuk është e pamundur.

Zoti ju bekoftë fort!

Bledar Raseni, Kapelan